

**STATUTI
i
Qëndrës "Youthful"**

I. KRIJIMI, SELIA, THEMELUESIT e "Youthful"

**Neni 1
Krijimi dhe Forma**

1. "Youthful" është organizatë jofitimprurëse pa antarësi, e pavarur, joqeveritare, jopolitike, e krijuar me vullnetin e lirë të themeluesve të saj, e cila nuk ndjek qëllime fitimi dhe është e hapur për bashkëpunim me të gjithë ata që punojnë për realizimin e qëllimeve të saj.
2. "Youthful" funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, Kodin Civil, Aktin e Themelimit, këtë Statut si dhe legjislacionin në fuqi.
3. "Youthful" funksionon si organizatë jofitimprurëse pa anëtarësi në formën e qendrës.

**Neni 2
Themeluesit**

"Youthful" themelohet nga 4 Persona Fizikë.

Themeluesit e "Youthful" janë si më poshtë:

1. Lude Taqe, e bija e Bujarit, lindur në Konispol, Sarande, me datelindje 14.06.1995 dhe banuese në Tiranë, e pajisur me leternjoftim ID me Numër Personal: J55614054S,
2. Igli Ali, i biri i Arbenit, lindur ne Konispol, Sarande, me datelindje 20.10.1995 dhe banues ne Tiranë, i pajisur me leternjoftim ID me Numër Personal: J51020064G,
3. Klea Sholla , e bija e Lorencit, lindur në Berat, me datelindje 12.10.1995 dhe banuese ne Tirane, e pajisur me leternjoftim ID me Numer Personal: J56012070U,
4. Gildijan Mulla i biri i Guximit, lindur ne Konispol, Sarande, me datelindje 01.10.1998 dhe banuese ne Tirane,e pajisur me leternjoftim ID me Numer Personal: J81001055H,

**Neni 3
Identiteti i Organizatës**

1. "Youthful" ka siglën, simbolin dhe vulën e saj të cilat e identifikojnë atë.
2. Sigla, simboli dhe vula e qendrës miratohen me vendim të Bordit Drejtues.
3. **Vula mban mbishkrimin "Youthful"** si dhe logon e miratuar nga Bordi Drejtues.



Neni 4

Selia

Qëndra e ka shelinë në adresën: Rruga "Budi/ Petraq Xhacka". Nr.8, Tiranë, Shqipëri

Neni 5

Kohëzgjatja

1. "Youthful" krijohet për një afat të pacaktuar.

Përfundimi apo kufizimi i veprimitarise së saj bëhet me vendim të motivuar të Bordit Drejtues për shkaqe dhe sipas mënyrave të përcaktuara në këtë Statut dhe në legjislacionin në fuqi.

II. QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMTARISË

Neni 6

Qëllimi

Qëllimi i qendrës është fuqizimi i rinisë si promotori kryesor i zhvillimit të vendit .

Ne synojmë të kontribuojmë në përforcimin e rolit aktiv të qytetareve dhe sidomos të të rinjve duke i afuar me vlerat qytetare dhe demokratike. Me anë të projekteve ne do të kontribuojë në fuqizimin e të rinjve në çdo rajon të Shqipërisë, në marrjen e një roli aktiv për jetën e tyre, familjen, shoqerinë, arsimin, ekonominë, mjedisin.

Neni 7

Fusha e veprimitarise

Fusha e veprimitarise është zhvillim projektesh, në funksion të përmirësimit të treguesve të zhvillimit rinos.

Organizata do të mbështesë zhvillimin e aktiviteteve në të mirë dhe interes të publikut, duke perfshirë çështje të tillë si: zhvillimin e karrieres, të drejtat e njeriut, demokracinë/qytetaria aktive, si dhe përmiresimin e treguesve të zhvillimit social-ekonomik. Gjithashtu, ajo do të ofrojë konsulenca, studime, botime, anketime, konferanca, seminare, trajnime, fushata sensibilizuese dhe mbështetëse ne fushen e arsimit, kultures, turizmit, ekonomise, mjedisit e te tjera. Kjo qendër per arritjen e qellimit për të cilin është krijuar ushtron edhe veprimitari të tjera, me kusht që ato të mos vijne në kundershtim me legjislacionin shqiptar.

Neni 8

Aktivitete të Qendrës

"Youthful" organizon aktivitete në përputhje me këtë Statut dhe ligjet në fuqi, duke mos u kufizuar vetëm në to, si:

1. Konferanca, kërkime shkencore dhe analiza studimore.
2. Tryeza të rrumbullakta, seminare, trajnime në fusha të ndryshme.
3. Misione monitorimi, deklarata shtypi, reagime publike dhe peticione.

4. Aktivitete sensibilizuese dhe informuese.

III. FINANCIMI DHE MOSSHËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 9 Burimet e financimit

1. Burimet i të ardhurave të "Youthful" janë:

- Tarifat pjesëmarrjes në aktivitetet e ndryshme;

- Të ardhura dhe financime nga donator të ndryshëm pa kufizim, vendas apo të huaj, përsone juridik apo fizik etj;
- Dhurata apo Kontribute vullnetare;
- Grante, nëngrante nga donator të ndryshëm qeveritarë ose jo qeveritare;
- Të ardhura të tjera në përputhje me ligjin.

2. Në çdo rast, evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe hartimi i dokumentacionit përkatës është i detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

3. Qendra nuk pranon donacione apo financime, të cilat rrjedhin nga burime kriminale dhe/ose të paligjshme si dhe në rastet kur këto donacione dhe financime janë të shoqëruara me kushte që do të kufizonin lirinë e vendimarrjes së Qendrës.

Neni 10 Shpërndarja e fitimeve

1. Fitimet e realizuara nga veprimtaria e Youthful përdoren në mënyrë ekskluzive për zbatimin dhe zgjerimin e objektit të veprimtarisë së Qendrës, në përputhje me misionin e krijimit të saj.
2. Çdo veprim i kundërt është i pavlefshëm dhe sjell përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 11 Administrimi financiar

1. Administrimi i financave dhe i pasurisë së "Youthful" bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Qendra mund të ketë llogaritë e saj bankare, që çelen dhe mbyllen sipas urdhërave të Bordit Drejtues.
3. Drejtori ekzekutiv përgatit raporte të detajuara mbi administrimin e pasurive të Youthful të cilat i paraqiten Bordit Drejtues për miratim cdo dymbëdhjetë muaj.

Neni 12 Veprimet financiare

1. Veprimet financiare të Qendrës kryhen sipas rregullave të vendosura me ligj. Bordi Drejtues i "Youthful" mbikqyr kryerjen e veprimeve financiare.



2. Nga buxheti i përgjithëm i "Youthful" i u transferohen degëve përkatëse në rrethe në llogaritë bankare të hapura për këtë qëllim, fondet për zhvillimin e aktivitetave të miratuara apo për nevojat e tyre administrative në përputhje me udhëzimet e Bordit Drejtues.

**Neni 13
Shtimi i Fondeve**

Shumë shtimi i fondeve dhe pasurive të Qendrës nëpërmjet aktivitetave të ndryshme, përfshirë dhe ato ekonomike, kryhet vetëm me synimin e përdorimit të të ardhurave, në çdo rast vetëm pë realizimin e qëllimeve për të cilat Qendra është krijuar.

IV. ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT

**Neni 14
Organet drejtuese dhe kompetencat e tyre**

Struktura e organeve drejtuese të organizates përbëhet nga:

- a) Bordi Drejtues si organi më i lartë vendimmarrës;
- b) Drejtori Ekzekutiv si organi më i lartë ekzekutiv.

Kompetencat e tyre percaktohen ne statut dhe rregulloren e brendshme te organizates.

**Neni 15
Perberja e organeve e para drejtuese**

Anetarët e parë te Bordit te Drejtorve janë: Lude Taqe, Igli Ali, Gildjan Mulla, Klea Sholla. Drejtor Ekzekutiv dhe perfaqesues ligjor është znj. Lude Taqe. Kryetar i bordit te drejtorve është Z. Igli Ali.

**Neni 16
Bordi i Drejtorve**

Organë më i lartë vendimmarrës i organizatës është Bordi i Drejtorve, i cili mblidhet jo më pak se njëherë në vit. Përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej saj, ka edhe keto detyra:

- vendos per ndryshimet ne statut,
- përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë, mbykqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre,
- shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit,
- miraton pasqyrat financiare qe paraqiten nga drejtori ekzekutiv, ku jepen me hollesi burimet materiale dhe financiare, perdonimet e tyre dhe pasurite e organizates,



- miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e organizatës dhe shpenzimet përvitin e ardhshëm,
- kontrollon rast pas rasti shpenzimet financiare te kryera nga organizata gjate realizimit te veprimtarise se saj, duke perfshire edhe ato te kryera per veprimtari te perbashketa me organizatën te tjera,
- nxjerr norma përrregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës,
- zgjedh ose emëron Drejtorin Ekzekutiv,
- krijojn komitete ose departamente të posaçme,
- mbikqyr veprimtarine e organizates, me qellim parandalimin e perdonimit te burimeve financiare per qellime terroriste, ne perputhje me legjisacionin ne fuqi per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit.
- vendos edhe për çeshtje të tjera të parashikuara shprehimisht në statut ose legjisacionin shqiptar per organizatat jofitimprurese.

Neni 17

Shkarkimi dhe mbarimi i mandatit të anëtarëve të Bordit Drejtues

Shkarkimi nga detyra i anëtarëve të Bordit Drejtues përpara mbarimit të mandatit bëhet me Vendim të themeluesve në rastet:

- Kur anëtari, në ushtrim të funksionit të tij, vepron në kundërshtim me Statutin;
- Kur anëtari, kryen sjellje të pahijshme dhe me faj që dëmtojnë rëndë reputacionin e Qendrës;
- Kur anëtari mungon në tre mbledhje radhazi, pa një shkak të justifikuar;
- Kur dënohet me një Vendim Penal të Formës së Prerë;

Mandati i anëtarit përfundon kur:

- Jep dorëheqjen;
- Humbet zotësinë përtë vepruar;
- Vdes;

Neni 18

Mbledhjet e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues mblidhet të paktën një herë në vit dhe thirret nga:

- Kryetari i Bordit
- Drejtori Ekzekutiv
- dy e treta e anëtarëve të Bordit.

Thirrja bëhet me mjete elektronike, që i dërgohet anëtarëve të paktën dy javë përpara datës së mbledhjes. Në raste urgjente thirrja mund të bëhet të paktën tre ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi përveç datës së mbledhjes përmban edhe rendin e ditës.

Handwritten signatures of the Board members, including the Chairman, Executive Director, and two other members, are displayed here.

Neni 19
Quorumi dhe marrja e vendimeve

Mbledhja e Bordit Drejtues konsiderohet e vlefshme kur në të marrin pjesë shumica e anëtarëve të tij. Çdo çështje që shqyrtohet, përfshihet në Procesverbalin e mbledhjes dhe vendimin përkatës në përfundim i saj.

Ai vendos me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

Për çështje të rendësishme dhe/ose urgjente, marrja e vendimeve mund të bëhet sipas sistemit qarkullues duke ju dërguar kopja e vendimit sëbashku me relacionin shpjegues të gjithë anëtarëve të Bordit në rrugë postare ose e-mail.

Neni 20
Përfaqësimi i anëtarëve

Anëtari i Bordit që nuk merr pjesë në mbledhje ka të drejtë që t'ja delegojë të drejtën e votës së tij një anëtari tjeter të Bordit. Në këtë rast, ai lëshon një autorizim me shkrim në emër të personit që do ta përfaqësojë. Një anëtar i Bordit nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar.

Gjithashtu, anëtari i Bordit që nuk merr pjesë në mbledhje ka të drejtë të shprehë me shkrim mendimin dhe votën e tij me e-mail.

Neni 21
Shpërblimi i anëtarëve

Anëtarët e Bordit Drejtues parimisht e ushtrojnë detyrën e tyre pa shpërblim.

Ata mund të marrin shpërblim vetëm për detyra të kryera në funksion të veprimtarisë së Qendrës.

Neni 22
Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv i Qendrës zgjidhet nga Bordi Drejtues me shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të Bordit.

Ai përgjigjet për administrimin e veprimtarisë së përditshme të organizatës dhe sigurimin e mbarevajtjes financiare, ne zbatim te rregullores se brendshme, statutit dhe vendimeve te Bordit te Drejtorse. Me urdherin e tij çelen dhe operojne llogarite bankare te organizates. Njekohesisht ai bashkepunon me Drejtorene e Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave, per te siguruar qe financimet e organizates nuk perdoren apo manipulohen per qellime terroriste.

Ai ka veçanërisht këto kompetenca kryesore:

- drejton veprimtarinë e Qendrës dhe e përfaqëson ligjërisht atë në të gjitha marrëdhëniet me të tretët;
- raporton në mënyrë periodike dhe sa herë që shihet e nevojshme për çështje të caktuara të Qendrës përpara Bordit Drejtues ;



- mund të marrë pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues kur gjykohet e nevojshme, por pa të drejtë vote;
- në përputhje me politikat e veprimtarisë së Qendrës dhe në zbatim të tyre punon për sigurimin dhe shtimin e fondeve të nevojshme nga subjekte dhe donatorët e ndryshëm;
- i propozon Bordit Drejtues strukturën dhe numrin e punonjësve të Qendrës si dhe ndryshimet e nevojshme në to;
- emëron dhe shkarkon nga detyra punonjësit e stafit administrativ të Qendrës;
- harton, aplikon dhe vë në zbatim projektet e marra në përputhje me misionin dhe objektivat e Qendrës;
- kontrollon mbarëvajtjen e administratës së Qendrës dhe harton një raport që ia paraqet Bordit Drejtues një herë në vit;
- i propozon Bordit Drejtues mbylljen e Qendrës për shkaqe të përcaktuara në këtë Statut apo në legjisacionin në fuqi;
- është përgjegjës për administrimin e fondeve në përputhje me misionin dhe objektivat e Qendrës;
- Kryen çdo detyrë tjeter kompetenca për të cilën nuk i është njohur asnjë organi tjetër në këtë Statut apo në legjisacionin në fuqi.
- Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje material nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste.
- Rregullat e veprimtarisë së Drejtorit Ekzekutiv caktohen nga statuti dhe aktet e Bordit Drejtues si organi më i lartë drejtues dhe vendimarrës.

Neni 23 Shkarkimi dhe mbarimi i mandatit të Drejtorit Ekzekutiv

Shkarkimi nga detyra i Drejtorit Ekzekutiv bëhet me Vendim të Bordit Drejtues në rastet kur:

- Kur Drejtori Ekzekutiv, në ushtrim të funksionit të tij, vpron në kundërshtim me Statutin;
- Kur Drejtori Ekzekutiv, kryen sjellje të pahijshme dhe me faj që dëmtojnë rëndë reputacionin e Qëndrës;
- Kur Drejtori Ekzekutiv mungon në tre mbledhje radhazi, pa një shkak të justifikuar
- Kur dënohet me një Vendim Penal të Formës së Prerë;

Mandati i Drejtori Ekzekutiv përfundon kur:

- Jep dorëheqjen,
- Humbet zotësinë për të vepruar,
- Vdes.

Neni 24
Departamentet

Pranë organizatës do të funksionojnë departamenti i rinise, zhvillimit social, ekonomik, shkrimit dhe menaxhimit te projekteve dhe kerkimeve.



Neni 25
Menyra e perfaqesimit ligjor

Përfajqësues ligjor organizates në raport me të tretët eshte Drejtori Ekzekutiv, i cili ka edhe të drejtën e delegimit të kësaj kompetence. Ai perfaqeson organizatën në marredhenie me subjektet private, publike, bankat, donatoret si dhe te gjitha nivelet e drejtimit që rregullojnë veprimtarinë e organizatës.

Neni 26
Administrata e organizatës

Administrata e organizatës përbëhet nga nëpunësit e saj. Ato merren në punë sipas nevojës, mbi bazën e konkursit dhe të kontratës së punës.

Neni 27
Procedurat per zgjedhjen ose ndryshimin e organive drejtuese

Bordi i Drejtoreve ka te drejte te beje zgjedhjen ose ndryshimin e organeve drejtuese të organizates, mbështetur ne rregulloren e brendshme, statutin e organizates dhe legjislacionin shqiptar per organizatat jofitimprurese. Ndryshimet në aktin e themelimit dhe në statut depozitohen brenda 30 ditëve nga data e marrjes në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, pranë gjykatës që ka dhënë vendimin për regjistrimin si person juridik të organizates.

Neni 28
Rregullat e mbledhjes dhe procedurat e votimit

Për të gjithë mbledhjet e Bordit te Drejtoreve mbahet protokoll i rregullt, i cili nënshkruhet nga të gjithë anetarët e pranishëm te saj. Bordi mblidhet jo me pak se një herë në vit dhe me pjesmarjen e jo më pak se 2/3-vë të anetarëve të tij. Ai vendos me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

Neni 29
Rregullat e mbledhjes dhe procedurat e votimit

Për të gjithë mbledhjet e Bordit te Drejtoreve mbahet protokoll i rregullt, i cili nënshkruhet nga të gjithë anetarët e pranishëm te saj. Bordi mblidhet jo me pak se një herë në vit dhe me

pjesmarrjen e jo më pak se 2/3-ve të anetarëve të tij. Ai vendos me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

Neni 30 Shpërblimi

Drejtori ekzekutiv dhe stafi administrativ, për punën e kryer përfitojnë pagesa, shpërblime dhe rimbursim për shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, me përashtim të rasteve kur anëtarët me vullnetin e tyre të lire dhe në kushte pamjaftueshmërisë financiare, zgjedhin të ushtrojnë detyrën e tyre pa shpërblim.

Neni 31 Zotërimet e Qendrës

Zotërimet e "Youthful", përfshijnë fondet e siguruara sipas ketij statuti, si dhe pasuritë e tij të luajtshme, dhe të paluajtshme. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, përfshirë edhe ato ekonomikë, synohet shtimi i fondeve dhe pasurive, të ardhura të cilat në çdo rast do të përdoren vetëm për realizimin e misionit për të cilin Qendra është krijuar.

Neni 32

Ndryshimi i statutit, aktiti te themelimit dhe rregullave te brendshme

Ndryshimi i statutit, aktit te themelimit dhe rregullave te brendshme behet me vendim te Bordit Drejtues me shumice te thjeshte votash. Vendimet depozitohen brenda 30 ditëve në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse.

Neni 33

Rregullat per bashkimin dhe ndarjen e organizates

Me vendim të Bordit, organizata mund të bashkohet me një ose disa subjekte te tjere jofitimprurëse, mund të transformohet ose te ndahet, gjithnjë mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar ne kete drejtim dhe duke e paraqitur brenda 30 ditëve pranë gjykatës vendimin përkatës, për ta depozituar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse.

Neni 34 Ndalimi i shpërndarjes së fitimit

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit të siguruar nga veprimtaritë e Qendrës në favor të themeluesve dhe subjekteve të tjera të përcaktuar në Statut ose Aktin e Themelimit, përvëç detyrimeve në formën e pagave dhe pagesave, shpërblimeve apo kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të organizatës.



Neni 35
Kriteret e administrimit te pasurisë

Administrimi i pasurisë së organizes bëhet mbështetur në rregulloren e brendëshme, statutin e organizatës dhe legjislacionin shqiptar ne kete drejtim. Organizata ka detyrimin ligor per te vertetuar se fondet e marra nga donatoret e ndryshem, jane perdorur per qellimin e deklaruar ne statut.

Neni 36
Liçencimi

Organzata për realizimin e qëllimit dhe të objektit të veprimtarisë, kur gjykon se ushtrimi i një veprimtarie paraprihet nga nevoja për marrjen e një leje apo liçence, i paraqet kërkesë organit shtetëror kompetent për marrjen e lejës. Një kopje e lejës së liçencës, e vertetur sipas ligjit depozitohet në regjistrin përkatës të gjykatës.

Neni 37
Bilancet financiare

Veprimtaria dhe viti finanziar i Qendrës mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Pas mbylljes së vitit finanziar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtori Ekzekutiv harton raportin mbi pasuritë, administrimin dhe gjendjen financiare të Qendrës si dhe bilancet përkatëse, të cilat ja paraqet pëmiratim Bordit Drejtues.

Neni 38
Eksperti kontabël i autorizuar

Për kontrollin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, Qendra mund të caktojë një ekspert kontabël të autorizuar, i cili emërohet nga Bordit Drejtues.

V. MBARIMI DHE LIKUIDIMI

Neni 39
Mbarimi dhe likujdimi i Qendrës

Veprimtaria e Qendrës mbaron kur vlerëson se janë permëbushur synimet për të cilat është krijuar apo në rastet kur themeluesit gjykojnë se Qendra ka plotesuar misionin si dhe per arsyet te tjera te percaktuara ne ligj

2. Në rast të prishjes së Qëndrës, për cilëndo nga arsyet e parashikuara më lart, Bordi Drejtues përcakton modalitet e likuidimit, emëron një apo më shumë likuidues duke i përcaktuar kompetencat.

Neni 40
Caktimi i likujduesit

Kur vendozet mbarimi i veprimtarisë, Bordi Drejtues zgjedh një apo me shumë likujdues për të ndjekur dhe përfunduar procedurat e likujdimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 41
Shpërndarja e pasurisë

Pas përfundimit të procedurave të likujdimit, pasuria e Qendrës që mbetet pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, nuk mund t'u shpërndahet themeluesve apo subjekteve të tjera të përcaktuar në Statut dhe Aktin e themelimit ose të afërmve të tyre.

Bordi Drejtues me vendim të veçantë të tij përcakton organizatat e tjera jofitimprurëse apo subjektet, të cilëve do t'ju shpërndahet pasuria që mbetet pas likujdimit.

VI. DISPOZITA KALIMTARE

Neni 42
Referimi në ligj

Për çështje, të cilat nuk janë parashikuar në Statut, zgjidhja e tyre bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" apo akte të tjera ligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse.

Neni 43
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Qendrës, palët përpiken për zgjidhjen me mirëkuptim, në te kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 44
Rregullorja e Brendshme

Rregullorja e brendshme përcakton mënyrën e funksionimit të "Youthful" në përputhje me statutin, procedurën e veprimtarisë si dhe marrëdhieniet e saj me të tretët.
Rregullorja miratohet me shumicë absolute votash nga Bordi i dreitorve.

Neni 45
Dispozitë e veçantë

Për çeshtjet që nuk gjijnë zgjidhje në këtë statut dhe nga Bordi i Dreitorve, gjykohet se ndikojnë në arritjen e qëllimit për të cilin është krijuar kjo organizatë, veprohet mbështetur në aktet e legjislacionit shqiptar për organizatat jofitimprurëse.

Lude Tago Gjeljan Mulla Ilia Sholla Joli Ali
N. P. N. G. M. S. J. A.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

Nº. 196 REP.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot më datën 14.01.2020 (Dymjë e njëzet), para meje Noteres ARTEMISA V. MEÇAJ (ARAPI), antare e Dhomës së Noterëve - Tiranë, me Studio Notieriale në adresën: Rruga e "Durrësit", Nº.81, Tiranë, u paraqitën personalisht:

1. **LUDE TAQE**, e bija e Bujar, lindur ne Konispol, Sarande, me 14.06.1995 dhe banuese ne Tirane, e pajisur me letërnjoftim ID nr. 032066923 dhe me Numer Personal: J55614054S, madhore dhe me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
2. **IGLI ALI**, i biri i Arben, lindur ne Konispol, Sarande, me 20.10.1995 dhe banues në Tiranë, i pajisur me letërnjoftim ID nr. 031630037 dhe me Numër Personal: J51020064G, madhor dhe me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
3. **KLEA SHOLLA**, e bija e Lorenc, lindur ne Berat, me 12.10.1995 dhe banuese ne Tirane, e pajisur me letërnjoftim ID nr. 031782070 dhe me Numer Personal: J56012070U, madhore dhe me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
4. **GILDIJAN MULLA**, i biri i Guxim, lindur ne Konispol, me 01.10.1998 dhe banues në Tiranë, i pajisur me letërnjoftim ID nr. 033140293 dhe me Numër Personal: J81001055H, madhor dhe me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.

Të larteppermendorit me deklaruan se dokumenti bashkëngjitur këtij vërtetimi, Statut i **Organizatës Jofitimprurëse "Youthful"**, e kanë redaktuar jashtë kësaj zyre, akt të cilin e nënshkruan para meje Noteres, me vullnetin e tyre, të lirë dhe të plotë, ndërsa unë, Noterja vërtetoj nenshkrimet e tyre, ne baze te Nenit 128 të Ligjit 110, date 20.12.2018 "Për Noterinë".

NOTE RE



Fatëllisja - Grupi (Vop)